

# **AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "MAS" SHPK**

## **KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, OJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA**

### **NENI 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesir**

#### **EMRI I SHOQERISE**

Une Alexis Glen , i datelindjes 27.10.1986 , banues ne France , i identifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr 14DL691151, qe ne vijim do te quhet "Ortak"

Une Shkelqim Memlikaj, i datelindjes 05.08.1970, banues ne France, e identifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr H008050495, qe ne vijim do te quhet "Ortak"

Une Mimoza Ahmetaj, e datelindjes 09.06.1967, banuese ne Gjermani, e identifikuar nga leternjoftimi elektronik me nr L8J594C8Z , qe ne vijim do te quhet "Ortak"

Sot me date 05.04.2024 vendosem te themelojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "MAS" Shpk ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

### **Neni 2:**

#### **Objekti I shoqerise**

**2.1.** Shoqeria ka kete objekt veprimtarie:

Shitje dhe blerje me shumice dhe pakice e produkteve te pijeve alkoolike, produkteve ushqimore, import-eksport te pijeve alkoolike, te produkteve ushqimore, sherbime te ndryshme, etj

### **Neni.3.**

#### **Regjimi Juridik**

**3.1.** Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

**3.2.** Me vendim të asamblese së ortakëve mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, n.q.s në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Ortaket do të pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjnë regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.

**3.3.** Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe në përputhje me ligjin

**3.4.** Shoqëria do të ketë vlerën e saj

#### **Neni 4:**

##### **Selia**

**4.1** Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Fortuzi, Banesa nr.26, Tiranë.

**4.2.** Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyrë përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

#### **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4**

##### **Te drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve**

**4.1.** Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

**4.2.** Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

**4.3.** Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**4.4.** Shoqëria përgjigjet ndaj të tjerëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj

**4.5.** Asambleja e ortakëve ka të drejtë të marrin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj

**4.6.** Asambleja e ortakëve ka të drejtë të bëjë propozime si dhe emergjente dhe shkarkojë, administratorin ose administratoret, punonjësit, ekspertin kontabel, apo likuidatoret

#### **Neni 5**

##### **Kohezgjatja 5.1**

Kohezgjatja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar

### **Kreu III**

## **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

### **Neni 5**

#### **Kapitali Themeltar**

**1.** Kapitali themeltar eshte 100.000 (njqind mije) leke dhe eshte i ndare ne 3 kuota, dy me vlere nominale 40. 000 leke sejcila prej tyre dhe nje kuote 20.000 leke.

**6.2.** Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte :

**Alexis Glen** 1 kuote, 40 % perkatesisht 40.000 leke

**Shkelqim Memlikaj** 1 kuote , 40 % perkatesisht 40.000 leke

**Mimoza Ahmetaj** 1 kuote 20 % perkatesisht 20.000 leke

### **Neni 6:**

#### **Zmadhimi dhc zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zrnadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre.

Ne asnie rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise,

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund tc fitohen apo kalohen nepermjet:

**a)** kontributit ne kapitalin e shoqerise,

**b)** shitblerjes;

**c)** trashegimise;

y) dhurimit;

d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

#### **KREU IV**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktirnin e shperblimeve per persont e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergaritjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute. Ortaku mund te perfaqesohet ne ansamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne ansamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite,

#### **Neni 9**

## **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese, Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Ne rastin e rranjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorurmit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;  
emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;

f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese; Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## **Neni 12**

### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

**1.** Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergj ithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkirn te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

**2.** Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson,

## **Neni 13**

### **Administrimi**

(1) Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shurne persona fizike si administratore te shoqerise.

Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripерteritjeje, Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

(2) Administratoret e nje shoqerie trcgtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk rnund te ernerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjellias. Cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozlta eshte i pavlefshem.

(3) Shkelqim Memlikaj caktohet si Administrator te pare te shoqerise deri ne cmerirnin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme,

## **Neni 14**

### **Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kane te drejte e detyrohen le:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;

ç) nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecanta për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblesën e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi,

## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e

pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

I. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshrne me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundersizim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne rnenyre solidarre.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese ne kundersizim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividends;

c) u shperndan aktivet shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht adrninistratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit



Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## **KREU V**

### **VITI FINANCIAR- EKSPERTET**

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 17**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## **KREU VI**

### **PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit

ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kornbetare te Rregjistrimit";

d) me vendim te gjykates;

**Fitimi i realizuar nga Shoqeria, mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do t'i mbetet ortakeve te shoqerise ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit**

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper",

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket. Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

**Neni 19**

**Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vednimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

**Neni 20**

**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar,

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21**

**Mosmarveshjet**

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKET E SHOQERISE**

**Alexis Glen**

**Shkelqim Memlikaj**

**Mimoza Ahmetaj**